

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	E drejta ndërkombëtare humanitare
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	O
Viti i studimeve:	IV (Moduli Ndërkombëtar)
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	7
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Dr.Iliriana Islami
Detajet kontaktuese:	Iliriana.islami@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	
	<p>E drejta ndërkombëtare humanitare, e cila përcakton rregullat që aplikohen në kohë të luftës, përfshinë analizën e kornizës ligjore dhe institucionale, që kryesisht përqëndrohet në katër Konventat e Gjenevës dhe në Konventat e Hagës. Kjo lëndë po ashtu synon analizën dhe shqyrtimin e dispozitave, rasteve, standardeve dhe shkeljeve të të drejtave të në kohë të luftës, si dhe masave në dispozicion kundër këtyre shkeljeve në sistemin aktual ndërkombëtar.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Kjo lëndë ka për qëllim parësor që të ofrojë një studim të rregullave dhe praktikës në fushën e të drejtës së luftës, që poashtu njihet si e drejta ndërkombëtare humanitare. Si struktura institucionale, ashtu dhe korniza ligjore në fuqi për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në kohë të luftës, dhe mekanizmat për zbatimin e kësaj kornize, -- duke përfshirë këtu dhe një analizë kritike të përshtatshmërisë së strukturës aktuale institucionale dhe zbatuese, -- paraqesin thelbin e përmbajtjes dhe të interesimit të kësaj lënde.</p> <p>Përfundimisht, struktura e kësaj lënde është e organizuar në një mënyrë që në thelb përfshinë tri kategori kryesore, dhe ka për qëllim: (1) Së pari, të ofrojë një hyrje konceptuale për të drejtën ndërkombëtare humanitare; (2) së dyti, të paraqesë dimensionin institucional të sistemit ndërkombëtar për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave në kohë të luftës, dhe (3) së treti, të analizojë dhe studiojë çështje</p>

	dhe raste specifike të gjykatave ndërkombëtare nga kjo fushë.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit me sukses të kësaj lënde, studentët janë në gjendje të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kuptojnë dhe shpjegojnë origjinat intelektuale, kuptimin dhe zhvillimin e diskursit së të drejtës ndërkombëtare humanitare; 2. Kuptojnë dhe shpjegojnë burimet e të drejtës ndërkombëtare humanitare, institucionet dhe instrumentet kryesore ligjore në fuqi; 3. Njohin dhe përdorin procedurat e përdorura për mbrojtjen e të drejtave në kohë lufte, si në nivel të Kombeve të Bashkuara ashtu dhe në nivele lokale; 4. Njohin dhe kuptojnë aspekte specifike të të drejtës së luftës, si për shembull të drejtat e civilëve, të plagosurve, të sëmurëve, personelit mjekësor e religjioz, personelit të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, robërve apo të burgosurve të luftës, etj; dhe 5. Analizojnë dhe diskutojnë rastet e vendosura nga Tribunali për Ish-Jugosllavi, Tribunali për Ruandë dhe tribunalet e tjera, që kanë të bëjnë me shkelje të ligjeve të luftës; 6. Përdorin dhe analizojnë raste dhe dokumente ligjore në kontekst të problemeve konkrete në botën reale. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			

Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	0.5	10	5
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	5	3	15
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	10	2	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	3	6
Projektet,prezentimet ,etj	10	2	20
Totali			175
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Metodologjia e mësimdhënies që do të përdoret në zbatimin e programit të kësaj lënde mbështetet në analizën e thellë të materialeve të përzgjedhura sipas udhëzimit të profesorit të lëndës. Studentët duhet të ballafaqohen me hulumtimin dhe interpretimin e rasteve konkrete, të zgjedhura midis atyre më të shpeshta dhe tipike në proceset vendimmarrëse dhe të ligjërbërjes ndërkombëtare në fushën e të drejtës humanitare, me prioritet ndaj atyre që kanë ose mund të kenë një korrelacion më të përafërt me përvojat në Kosovë dhe rajon. Me fjalë të tjera, nuk do të prezantohen vetëm rregullat themelore në burimet e përshkruara, por problemet më të shpeshta që shfaqen gjatë aplikimit të tyre, për të ndriçuar strukturën e tyre dhe problemet interpretuese që lidhen me to.</p> <p>Me qëllim të përgatitjes sa më të mirë, kërkohet që paraprakisht të lexohen materialet për temën e cila diskutohet në orën(-t) pasuese, për të krijuar një kuptim të përgjithshëm dhe familjarizim me materialin dhe tërësinë e ndryshueshmërinë e temave që do të diskutohen në ligjërata. Pjesëmarrja aktive në diskutime si dhe prezentimet e studentëve janë pjesë e rëndësishme e metodologjisë së kësaj lënde.</p>		
Metodat e vlerësimit:			

	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja aktive në ligjërata dhe ushtrime - 10% - Testi (me përgjigje me disa opsione) në pjesën e parë të semestrit - 10% - Testi (me përgjigje me disa opsione) në pjesën e dytë të semestrit - 10% - Prezentimi i secilit student në temën e caktuar në konsultim me profesorin - 10% - Provimi përfundimtar - 60% <p>Do të ketë një politikë rigoroze në përcaktimin e vijueshmërisë së lëndës. Pjesëmarrja aktive, përmbajtësore dhe e rregullt në ligjërata vlerësohet me 10 për qind (%). Nëse pjesëmarrja, në <u>cilësi</u> dhe <u>vijueshmëri</u>, është e mjaftueshme për të marrë këtë përqindje, vendimi përfundimtar për të përcaktuar këtë i takon profesorit të lëndës.</p>
Literatura	
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> • ZEJNULLAH GRUDA, MBROJTJA NDËRKOMBËTARE E TË DREJTAVE TË NJERIUT I (UNIVERSITETI I PRISHTINËS: PRISHTINË, 2001; ose botimi i katërt, 2007). • KATËR KONVENTAT E GJENEVËS TË VITIT 1949 DHE KONVENTAT E HAGËS PËR TË DREJTËN E LUFTËS • JEAN S. PICTET, PARIMET E TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE HUMANITARE (PUBLIKIM DHE PËRKTHIM I KRYQIT TË KUQ NDËRKOMBËTAR – ICRC)
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> • RASTET KRYESORE TË ICTY DHE ICTR QË KANË TË BËJNË ME SHKELJE TË LIGJEVE TË LUFTËS (WWW.ICTY.ORG DHE WWW.ICTR.ORG). <p><i>Tekstet e rekomanduara (në gjuhën angleze):</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • COMMENTARY ON THE FIRST GENEVA CONVENTION FOR THE AMELIORATION OF THE CONDITION OF THE WOUNDED AND SICK IN ARMED FORCES IN THE FIELD (JEAN PICTET, ICRC, GENEVA, 1952) • COMMENTARY ON THE SECOND GENEVA CONVENTION FOR THE

	<p>AMELIORATION OF THE CONDITION OF WOUNDED, SICK AND SHIPWRECKED MEMBERS OF ARMED FORCES AT SEA (JEAN PICTET, ICRC, GENEVA, 1960)</p> <ul style="list-style-type: none"> • COMMENTARY ON THE THIRD GENEVA CONVENTION RELATIVE TO THE TREATMENT OF PRISONERS OF WAR (JEAN DE PREUX, ICRC, GENEVA, 1960) • COMMENTARY ON THE FOURTH GENEVA CONVENTION RELATIVE TO THE PROTECTION OF CIVILIAN PERSONS IN TIME OF WAR (OSCAR UHLER, HENRI COURSIER, ICRC, GENEVA, 1958) • HOW DOES LAW PROTECT IN WAR? CASES, DOCUMENTS AND TEACHING MATERIALS ON CONTEMPORARY PRACTICE IN INTERNATIONAL HUMANITARIAN LAW (MARCO SASSOLI, ANTOINE A. BOUVIER, ANNE QUINTIN, 3RD ED.2011, ICRC, GENEVA)
--	--

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	<p>HYRJE</p> <p>(Përmbajtja e lëndës, metoda, organizimi, kërkesat dhe vlerësimi)</p>
Java e dytë:	<p>HISTORIKU I ZHVILLIMIT TË TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE HUMANITARE</p> <p>(GRUDA, FQ. 259-270)</p> <p>(MATERIALE TË PËRZGJEDHURA NGA FAQJA ZYRTARE E ICRC.ORG)</p>
Java e tretë:	<p>PARIMET DHE BURIMET E TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE HUMANITARE</p> <p>Pictet, <i>fq. 6-30.</i></p>
Java e katërt:	<p>INSTRUMENTET LIGJORE NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E TË DREJTËS HUMANITARE:</p> <p>KATËR KONVENTAT E GJENEVËS DHE KONVENTAT E HAGËS</p>

	<i>Gruda, fq. 260-300.</i>
Java e pestë:	KONVENTAT E HAGËS DHE KUFIZIMET E TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE HUMANITARE SA I PËRKET ARMATIMIT DHE MJETEVE TË TJERA NË LUFTË <i>Teksti i Konventave të Hagës</i>
Java e gjashtë:	KONVENTA E PARË E GJENEVËS TË PLAGOSURIT DHE TË SËMURIT NË FUSHËBETEJË <i>Dispozitat e Konventës së Parë të Gjenevës</i>
Java e shtatë:	KONVENTA E DYTË E GJENEVËS TË PLAGOSURIT DHE TË SËMURIT NË UJËRA <i>Dispozitat e Konventës së dytë të Gjenevës</i>
Java e tetë:	KONVENTA E TRETË E GJENEVËS ROBËRIT E LUFTËS <i>Dispozitat e Konventës së Tretë të Gjenevës</i>
Java e nëntë:	KONVENTA E KATËRT E GJENEVËS MBROJTJA E CIVILËVE NË LUFTË <i>Dispozitat e Konventës së Katërt të Gjenevës</i>
Java e dhjetë:	PROTOKOLLET SHITESË TË KONVENTAVE TË GJENEVËS DHE NENI 3 I PËRBASHKET I KATËR KONVENTAVE: Konfliktet jo ndërkombëtare dhe ato të ndërkombëtarizuara <i>Dispozitat e Protokolleve dhe neni 3 i përbashkët</i>
Java e njëmbëdhjetë :	TERRORIZMI NDËRKOMBËTAR DHE E DREJTA NDËRKOMBËTARE HUMANITARE <i>Artikuj të dorëzuar nga profesori i lëndës për student</i>
Java e dymbëdhjetë:	KRYQI I KUQ NDËRKOMBËTAR, PERSONELI MJEKËSOR, PERSONELI RELIGJIOZ, EMBLEMAT <i>Dispozitat e konventave të Gjenevës</i>
Java e trembëdhjetë:	RASTET E TRIBUNALEVE NDËRKOMBËTARE DHE SHQYRTIMI I SHKELJEVE TË LIGJEVE TË LUFTËS

	<i>Rastet kryesore të ICTY (Tribunalit për ish-Jugosllavi)</i>
Java e katërbëdhjetë:	<p>RASTET E TRIBUNALEVE NDËRKOMBETARE DHE SHQYRTIMI I SHKELJEVE TË LIGJEVE TË LUFTËS</p> <p><i>Rastet kryesore të ICTR (Tribunalit për Ruandë)</i></p>
Java e pesëmbëdhjetë:	PREZENTIMET E STUDENTËVE

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<i>Cakto politikat e mirësjelljes konfor statusit të UP-së.</i>	